



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

NJOFTIM PËR SHTYP

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, më datë 10.06.2025, ora 10.00, pasi vlerësoi kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me objekt “Vleftësim arrestimi në flagrancë, caktim mase sigurimi” ndaj shtetasve nën hetim: V.B, Y.D, L.H, D.M, F.B

Vendosi:

1. Të vleftësojë si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit V.B, të kryer në datë 07.06.2025 ora 17.00.
2. Caktimin si masë sigurimi personal ndaj shtetasit V.B (i biri i X dhe X, i datëlindjes X) atë të “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale lidhur me hetimet për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 i Kodit Penal.
3. Urdhërohet policia gjyqësore që ta çojë menjëherë në një institut paraburgimi personin nën hetim V.B.
4. Të mos vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit Y.D, të kryer në datë 07.06.2025 ora 22.00.
5. Caktimin e masës së sigurimit ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” e parashikuar nga nenet 240/1 gërma “a” dhe 242 të K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim Y.D (i biri i X dhe X, i datëlindjes X), si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
6. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit Y.D nga ambientet në të cilat ndodhet, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
7. Të mos vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit L.H, të kryer në datë 07.06.2025 ora 20.30.
8. Caktimin e masës së sigurimit ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” e parashikuar nga nenet 240/1 gërma “a” dhe 242 të K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim L.H (i biri i X dhe X, i datëlindjes X), si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
9. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit L.H nga ambientet në të cilat ndodhet, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
10. Të mos vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit D.M, të kryer në datë 07.06.2025 ora 21.30.
11. Caktimin e masës së sigurimit ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” e parashikuar nga nenet 240/1 gërma “a” dhe 242 të K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim D.M (i biri i X dhe X, i datëlindjes X), si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

12. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit D.M nga ambientet në të cilat ndodhet, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
13. Të mos vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit F.B, të kryer në datë 07.06.2025 ora 20.00.
14. Caktimin e masës së sigurimit ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” e parashikuar nga nenet 240/1 gërma “a” dhe 242 të K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim F.B (i biri i X dhe X, i datëlindjes X), si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
15. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit F.B nga ambientet në të cilat ndodhet, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
16. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe policia gjyqësore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, duke u urdhëruar njëkohësisht të njoftojë me këtë vendim organin kompetent.
17. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Korçë, sot në datë 10.06.2025.

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË**